

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e 50, deri më 17.12.2023)**

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së 50 të vitit 2023 (nga 11.12-17.12.2023), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **134 (I=7,3/100.000)** të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 54,0% më shumë krahasuar me javën e kaluar (n=87).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=111) është regjistruar një rritje prej 20,7%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=116) është regjistruar një rritje prej 15,2%. (Grafiku 1)

Gjatë javës së 50-të të vitit 2023, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 31 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. Nuk kanë rezultuar raste pozitive për Influenza. Është regjistruar një rast me COVID-19 dhe katër me virus sincial respirator (RSV).

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=30,6/100.000), pra ende nuk është arritur pragu i hyrjes në sezonin e gripit (Grafiku 1).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 58 persona, nga 0-4 vjet – 32, tek grupmosha nga 5-14 – 31 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 13 persona. Incidencë më e lartë (27,5/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 12 QShP/NjR: Dibër – 71, Tetovë – 14, Strumicë-12, Kumanovë – 10, Manastir edhe Prilep – 6, ndërsa në Kërçovë, Kavadar, Shkup, Gostivar dhe Radovish numri i rasteve të raportuara është më pak se 5.

Nga 11 njësi raportimi që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, ndërsa në 1 (Dibër) – aktivitet mesatar (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e 50 2023



MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është **685 (I=37,3/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=406) numri i rasteve të regjistruara është rritur për për 68,7%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=698) është regjistruar një rënie prej 1,9%.

Raste janë raportuar nga gjithsej 18 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (352) dhe incidencë më e lartë kumulative (1.839,8/100.000) është regjistruar në Dibër.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 293 (42,8%), ndërsa incidencë më e lartë (161,5/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=168).

Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 28,6%
- nëntor – 268 raste ose 39,1%
- dhjetor – 221 raste ose 32,3%

Deri më tani gjatë këtij sezoni nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e 50, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 357 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast është regjistruar një rast pozitiv 1 Influenza A(H1) dhe tre raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 13 raste me Virus Respirator Sincicial (RSV).

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së 50 janë raportuar gjithsej 44 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve

(n=24; 54,5%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=26; 59,1%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 194, me 1 rast të raportuar në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 22,7% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 31,3% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së 50 për analizë laboratorike kanë arritur 25 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në 24 mostrat e analizuara tek një është vërtetuar prani e virusit të gripit AH1pdm, në një mostër është vërtetuar COVID-19, ndërsa në 16 mostra virusi sincicial respirator.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 361 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=127; 35,2%) janë raportuar nga Instituti për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët KOZLE. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=205; 56,8%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 2090, nga të cilët 12 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 17,3% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 36,0% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Është regjistruar edhe një rast i vdekjes i raportuar nga SK në Shtip, që i përket grupmoshës mbi 65 vjet, pa komorbiditete dhe pozitiv për COVID-19.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 173 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në një mostër u vërtetua Influenza B dhe në 2 Influenza AH1pdm. Janë regjistruar 12 raste pozitive me COVID-19. Nga mostrat SARI, 149 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 78 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit.

KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje e numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është ende nën kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit nuk tregojnë aktivitet të virusit të influencës në 7 nga dhjetë javë të mbikëqyrjes. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka intensitet të ulët të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 57.190 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2190 persona.

Deri në javën e 50 në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 60.100 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

- Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e 49 të vitit 2023 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:
- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 16 nga 39 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit vazhdon të rritet dhe po i afrohet pragut sezonal, aktiviteti i COVID-19 është rritur por ngadalë po fillon të bjerë, ndërsa i RSV vazhdon të rritet, por me një shkallë më të ulët se sa gjatë javëve të kaluara.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV janë në nivele më të ulëta me një rritje të lehtë, ndërsa RSV po shënon rritje këto 5 javët e fundit, kryesisht tek fëmijët nën 5 vjet.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza Influenza A (97%) - A(H1)pdm09 (51%) dhe A(H3) (49%).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është rritur në 9% krahasuar me 6% një javë më parë. Pozitiviteti mesatar varionte nga 0-47%.
- SARS-CoV-2 është në 17% krahasuar me 17% javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar i vendit ishte 9% (shtrirja: 0–28%).
- RSV u rrit në 18% krahasuar me 17% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit ishte 14% (shtrirja: 0-50%).

Nga 33 vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet të lartë, 5 kanë raportuar intensitet mesatar, 15 të ulët dhe pjesa tjetër kanë raportua intensitet bazë.

Nga 37 vende që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 7 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 4 - rajonale, 16 - sporadike, 3 - lokale dhe pjesa tjetër kanë raportuar se nuk ka aktivitet të virusit të gripit.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik